



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1171 Prot.

Tiranë, më 4/10/2013

REKOMANDIM

Nr. 32 datë 04/10 2013

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit mbi kontrolluesin, "Ministria e Drejtësisë".

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrin nr. 196, datë 01.10.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "Ministria e Drejtësisë".

Objekti i kontrollit administrativ ishte:

- **Verifikimi i ankesës së shtetasit D.D drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila lidhet me "publikimin e të dhënave personale të denoncuesve kundër korrupsionit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë".**

Grupi i kontrollit administrativ:

- U njoh me procedurën që kontrolluesi "Ministria e Drejtësisë" realizon gjatë publikimit të të dhënave personale të denoncuesve kundër korrupsionit si dhe palëve të treta në faqen zyrtare të institucionit online.
- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësues të kontrolluesit;

Gjatë kontrollit administrativ grupit të kontrollit i janë krijuar kushte për ushtrimin e kontrollit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit u treguan bashkëpunues në të gjitha fazat e ushtrimit të kontrollit.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson reagimin e menjëhershëm të kontrolluesit pas dhënies të Vendimit të Ndërmjetëm Nr. 1, datë 01.10.2013, në lidhje me pezullimin e përpunimit të të dhënave personale, që përmbahen në listën e denoncuesve kundër korrupsionit, deri në dhënien e rekomandimit nga ana e tij, në lidhje me çështjen e ngritur në ankesë.

Duke filluar nga muaji Shtator i vitit 2013 kontrolluesi ka filluar publikimin në faqen e tij zyrtare në internet të të dhënave personale të denoncuesve kundër korrupsionit si dhe palëve të treta. Denoncimet (dokumentat përkatëse) publikohen pas një kontrolli nga specialisti përkatës dhe më pas hidhen online. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave

rezulton të jetë goditja dhe lufta kundër fenomenit të korrupsionit në fushën e drejtësisë, nëpërmjet paraqitjes së denoncimeve dhe ankesave të individëve dhe trajtimi i tyre, si dhe publikimi i këtyre denoncimeve për informimin e publikut. Vërehet se ky proces i mbledhjes dhe i përpunimit të mëtejshëm të këtyre të dhënave nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është i bazuar në ligj dhe në përputhje me Nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Paraqitja e këtyre denoncimeve dhe ankesave është vendosur të realizohet nëpërmjet aplikimit elektronik në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë (portalit). Bërja publike në vetvete është pjesë e procesit të mbledhjes, ruatjes, përpunimit të të dhënave personale të individëve të përfshirë në këtë proces dhe përbën përhapje të të dhënave, pasi aksesohen nga një publik i gjerë. U vërejt, se të dhënat personale të kategorive të ndryshme të subjekteve të të dhënave janë tërësisht të identifikueshme, si subjektet ankues, personat ndaj të cilëve bëhet dononcimi apo paraqitet ankesa, si dhe palë të treta.

Portali që mundëson këtë publikim aksesohet në faqen zyrtare në internet të kontrolluesit përmes adresës: <http://ankesa.justice.gov.al/> Në ndërfaqen e komunikimit të kësaj faqeje, individëve që duan të denoncojnë një rast u jepet mundësia të ngarkojnë në portal, të dhëna si: emër/mbiemër, telefon, email, foto, video si dhe dokumenta të formateve dixhitale të ndryshme. Në panelin djathtas, shfaqen denoncimet e ardhura me gjithë informacionin e tyre duke përfshirë të dhënat personale të palëve dhe dokumentat e ngarkuara nga denoncuesi, të cilat mund të shkarkohen pa kufizim nga kushdo.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, pavarësisht ligjshmërisë së mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për qëllimin e sipërpërmendur, përhapja nëpërmjet publikimit të plotë të të dhënave që e bëjnë të identifikueshëm ankuesin/denoncuesin dhe palët e treta, përbën shkelje të privatësisë dhe të të dhënave personale, pasi çënohet siguria e këtyre të dhënave, të drejta këto të mbrojtura nga Neni 35 i Kushtetutës, Neni 8 i Konventës Evropiane për “Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut”, si dhe ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, sipas të cilit në nenin 2 të tij përcaktohet se “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private”.

Përsa i përket të dhënave për personat publik, pra personat që ushtrojnë një detyrë publike dhe ndaj të cilëve është paraqitur denoncimi/ankesa, ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar nuk gjen hapsirë zbatimi. Sipas Nenit 4/4/b : “...Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave: b) vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publikë zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”.

Gjithashtu, Komisioneri vëren se është e domosdoshme që në faqen e internetit ku dononcuesit paraqesin rastin të realizohet informimi i tyre përse i përket mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të tyre dhe i të drejtave që gëzojnë bazuar në ligj. Sipas nenit 18/2 e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar... “Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare....”.

Vërejmë dhe e shikojmë të domosdoshme që në Rregulloren e Brendshme të kontrolluesit, të parashikohen rregulla të veçanta për mënyrën e përdorimit dhe të menaxhimit të këtij portali, të drejtat dhe detyrat për menaxhimin e anës teknike të faqes zyrtare në internet, duke marrë në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë e tyre, si dhe konfidencialitetin,

bazuar kjo në nenin 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, sipas të cilit...*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të pa autorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*”. Gjithashtu, politikat e privatësisë të hartuara dhe të miratuara nga kontrolluesi duhet të publikohen në faqen e internetit.

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative:

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar:
 - Publikimi në faqen zyrtare në internet i të dhënave personale të subjekteve denoncues/ankues si dhe i palëve të treta të realizohen në mënyrë të tillë që ata të mos jenë të identifikueshëm;
 - Të hartohen rregulla për mënyrën e mbledhjes, përdorimit, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të mbledhura nëpërmjet këtij portali. Për hartimin e këtyre rregullave, Autoriteti i Komisionerit ofron asistencën e tij;
 - Të merren të gjitha masat e dubura teknike dhe organizative për mënyrën e përdorimit dhe të menaxhimit të këtij portali;
 - Politikat e Privatësisë të miratuara të publikohen në faqen zyrtare të internetit.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të realizohet informimi i subjekteve përsa i përket mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të tyre dhe i të drejtave që gëzojnë bazuar në ligj;
3. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit... *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues,veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij,vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

